

## JETA SHKENCORE

### SIMPOZIUMI SHKENCOR “ALEKSANDËR XHUVANI NË LEKSIKOGRAFINË SHQIPTARE”

Departamenti i Leksikologjisë, Terminologjisë dhe Gjuhësisë së Zbatuar i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhësisë të Fakultetit të Shkencave Humane, pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, organizuan në mjediset e Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, dt. 3 dhjetor 2021, Simpoziumin shkencor “Aleksandër Xhuvani në leksikografinë shqiptare”.

Vepra e Aleksandër Xhuvanit (1880-1961), e shtrirë në gjashtë dhjetëvjeçarë pune të pareshtur për gjuhën e shqiptarëve dhe shkollat e tyre, qëndron e kthjellët dhe e vlershme sot e gjithë ditën për kulturën tonë, kur bëhen 60-vjet nga vdekja e gjuhëtarit, dhe prezantohet në vendlindjen e tij, Elbasan, Fjalori i gjuhës shqipe.

Fjalori, i përgatitur për botim nga Engjëllushe Karaj (ASA), u promovua në këtë simpozium shkencor. Në Fjalor kanë zënë vend një pasuri me rëndësi gjuhësore kombëtare, që shkon në rreth 45.000 skeda.

Valter Memisha bëri një përjasje mes veprave të Xhuvanit dhe Kristoforidhit.

“Fjalor i gjuhës shqipe” i Xhuvanit ose “Kristoforidhi i vogël”, ashtu si vepra e Kristoforidhit, të cilin e përgatiti për botim Xhuvani dhe u botua më 1961, është mbledhje e fjalëve dhe shprehjeve frazeologjike shqipe kryesisht nga goja e popullit. Xhuvani ka regjistruar saktë fonetiki dhe semantiki njësitë, ashtu si i ka dëgjuar, një kriter i patjetërsueshëm i punës në terren dhe i leksikografisë dialektore. “Dhe përsëri përjasja me Kristoforidhin”, vëren prof. dr. Memisha, “i cili sipas Xhuvanit, ka qenë një vërejtës i mirë dhe ka pasë vesh të një fonetikani të mirë”.

Më pas fjalën e mori Teuta Toska me kumtesën “Shtresa e leksikut fetar në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të A. Xhuvanit”. Sipas autores, leximi dhe vjelja e termave fetarë në Fjalorin e A. Xhuvanit mundëson jo vetëm të kuptohet natyra dhe lloji i termit fetar në një fjalor që ka një përmasë historike të

dyfishtë: së pari, leksiku është mbledhur në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX, para ndalimit të fesë në Shqipëri, së dyti, është botuar para viteve të ndryshimeve politike, që sollën sërish lirinë shpirtërore të shqiptarët - por edhe të krijohet ideja se si ishte shqipja para vitit 1967. Sa kishin arritur të hynin në leksikon e popullit fjalët e lëvruara të përkthimeve fetare që nga Buzuku dhe sa fjalë të leksikut popullor ishin terminologjizuar në terma fetarë prej përkthyesve? Në një kohë kur gjallërohen, përmirësohen dhe ripërkthehen qoftë Bibla e Kurani, qoftë edhe literaturë e shumtë teologjike, nevoja për termin fetar, anipse historik, është gjithnjë e madhe. Kështu edhe nevoja për një fjalor si ky i Xhuvanit.

“Elemente etno-kulturore në veprën “Fjalori i gjuhës shqipe” i A. Xhuvanit” ishte kumtesa e mbajtur nga Artur Lama. Autori shpreh mendimin se “Fjalori i gjuhës shqipe, i A. Xhuvanit, në një vështrim të përgjithshëm, mund të kundrohet si një libër fjalësh a tekst ku lexuesit vendosin lidhje shumëpërmasore. I vështruar si një kod epistemik, mundëson një tërësi njohjesh kulturore për jetën reale dhe imagjinare në trevat shqipfolëse falë fjalëve emërtuese, si: marash; puncir; talikë; fati etj.; i kundruar si një strukturë me simbolikë etike, çel shtegun për jetësimin e normave e dokeve sociale përmes fjalëve e shprehjeve të tilla si: ajo e vrame ka me u pleqnue dy gjaqe; gjaku i grues ishte sa një gjysë gjaku; i vëzhguar si një subjekt fatik, fjalori hap udhën të zbulojmë tjetrin përmes ligjërimeve të folura atë shkruara, veprimeve e taktikave ligjërimore, p.sh., atyne nuk i djeg fëmia huej (nuk u dhëmbet); djali ishte figura e shtëpisë (arbër. e Greq.) etj.”

Kumtesa e titulluar “Kur bukuria e gjuhës nxit guximin shkencor”, e mbajtur nga Tomorr Plangarica, është përpjekje për të interpretuar sfidën me të cilën përballemi ndërsa njihemi me një vepër postume, siç është “Fjalori i gjuhës shqipe”, i A. Xhuvanit, për më tepër një vepër e papërfunduar dhe e papërpunuar përfundimisht si objekt i kërkimit shkencor në gjallje të autorit; por një vepër që është produkt i një pune të vijueshme dhjetëravjeçare të Xhuvanit, nxitur nga pasuria e bukuria e shqipes së folur e të shkruar të cilën ai e regjistroi me skrupulozitet e në realie gjuhësore në një hapësirë tejet të gjerë shqipfolëse.

Edhe pse Xhuvani nuk arriti ta shndërrojë plotësisht tërë atë pasuri në objekt shqyrtimi shkencor, mendimi ynë i sotëm gjuhësor ka të gatshme parakushtet për përvijimin e objekteve të shumtë të kërkimit në këtë lëndë të begatë që Xhuvani sjell në këtë fjalor; kjo vepër u ka shkurtuar së tepërmi rrugën studiuesve drejt transformimit të nevojshëm të lëndës gjuhësore në objekt kërkimi shkencor në një sërë fushash të sotme të gjuhësisë.

Kumtesa e radhës ishte ajo e Rozana Rushitit, me temë “Prania e fjalësit të Xhuvanit në fjalorët e gjuhës shqipe dhe fushat e përdorimit”

Si mund ta klasifikohet kjo vepër leksikografike e autorit tonë? Ajo nuk rreshtohet ndër fjalësit dialektorë, që përbëjnë një pasuri më vete, prej mijëra e

mijëra leksemash; nuk është, gjithashtu, as një fjalor shpjegues i mirëfilltë i shqipes, përjashtim me ata që janë botuar deri më tani. Kemi bindjen se ky Fjalor i Xhuvanit është një vepër *mischellaneo*, me bazë *selectae* – siç janë përzgjedhjet që ka bërë gjuhëtari ynë e që gjenden në brendësi të saj.

Sa i takon Fjalorit të A. Xhuvanit, bie në sy se është në unison me vëllimin që kanë lemat, parë sipas shkronjave të fjalorët tanë, një fakt që u përket për afërsisht të gjithë fjalorëve të gjuhëve natyrore, së paku, fjalorëve dygjuhësh që kemi deri më sot për gjuhët indieuropiane. Kështu në anë numerike, peshën e fjalëve të një gjuhe e mbajnë shkronjat: A/ C/ I/ K/ L/ M/ P/ R/ S/ T – pra, janë vetëm 10 shkronja që bartin pjesën më të madhe të leksemave të mbledhura prej gjuhëtari tonë të shquar.

Më pas e mori fjalën Juljana Kume me kumtesën “Vendi i krijimtarisë letrare në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të A. Xhuvanit”, kumtesë e cila ka si qëllim evidentimin dhe analizimin e leksikut të përfshirë në shkrimet e autorëve të Vjetër, të Rilindjes dhe autorëve të periudhës kur qe gjallë autori i veprës leksikografike shqip-shqip “Fjalori i gjuhës shqipe”, Aleksandër Xhuvani. Ky kumtim, synon të vërë theksin jo vetëm tek fjala përfshirë në veprat letrare dhe mesazhin që ajo përcjell, por të ofrojë biografinë e plotë të fjalës së rrallë në mikrostrukturën e saj nga një shkrimtar (vepër) tek tjetri dhe nga një e folme tek tjetra ashtu sikurse autori e përshkruan në veprën leksikografike “Fjalori i gjuhës shqipe”, material i pasur për analizim historik të fjalës, dialektor, leksiko-semantik e stilistik.

Kumtesa e Meleq Shopit titullohej “Elbasanizmat (fjalët dhe frazeologjizmat) në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të A. Xhuvanit, Tiranë, 2020”. Ky punim analizon përmes shembujve të dhënë në “Fjalorin e Gjuhës Shqipe” të A. Xhuvanit, Tiranë, 2020 leksikun e vjelë nga prof. A. Xhuvani e, pikërisht elbasanizmat (fjalët dhe frazeologjizmat), duke shfrytëzuar gjuhën e gjallë të popullit, si dhe materiale të tjera gjuhësore. Në fjalor përfshihen 1223 elbasanizma herë si lema kryesore, herë si dysorë a sinonime krahinore, duke përfshirë një areal gjeografik relativisht të gjerë. Gjithashtu, ky fjalor përbën një vlerë të shtuar nga ana dialektologjike ku pjesa më e madhe e tyre janë dialektalizma semantike (ose krahinorizma).

Kumtesa e radhës ishte ajo e Lura Turhanit, Resul Telhajt dhe Aurela Bashës me temë “Foljet që shprehin lëvizje në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të A. Xhuvanit”

Në këtë kumtesë u morën në shqyrtim korpusi i foljeve që shënojnë lëvizje, për të nxjerrë në pah natyrën semantike të tyre në gjuhën shqipe dhe për të treguar pasurinë leksikore të “Fjalorit të gjuhës shqipe” të A. Xhuvanit. Pasuria shihet në numrin e përgjithshëm të foljeve (3533) dhe numrin e madh të atyre që shënojnë lëvizje (385). Foljet e lëvizjes klasifikohen në bazë të përbërësve semantikë që ato leksikalizojnë: me një përbërës, me dy përbërës, me tre përbërës, me katër përbërës. Dy janë grupet që kanë më shumë

elemente: foljet të cilat veç lëvizjes shënojnë edhe mënyrën e lëvizjes (156) dhe ato që shënojnë veç lëvizjes edhe trajektoren e lëvizjes (125).

E fundit që kumtoi ishte Engjëllushe Karaj, me “Etnobiologjizmat në veprën leksikografike “Fjalori i gjuhës shqipe” i Aleksandër Xhuvanit”. Objekt i kësaj kumtese ishte pasuria leksikore që ngërthen ky Fjalor e konkretisht etnobiologjizmat (ku përfshihen emërtimet për bimë dhe emërtimet për kafshë, ndryshe etnobotanizmat dhe etnozoolgjizmat), shtresë fjalësh kjo që zë një vend të rëndësishëm në këtë vepër. Mjafton dhe kjo shtresë e etnobiologjizmave, për të pohuar se pasuria leksikore e sjellë nga Aleksandër Xhuvani, tashmë përmes Fjalorit të tij, ka vend, peshë, e rëndësi të madhe në leksikun e shqipes në përgjithësi, por dhe për të sipërmarrë studime nga më të ndryshmet dhe me interes gjuhësor, kulturor etj.

**Teuta Toska, Engjëllushe Karaj**

## TABLE OF CONTENTS

GUNNAR SVANE	How to read Budi's "Speculum Confessionis"?	5
TOMORR PLANGARICA	'The prologue' of the <i>Arbëresh Singer</i> of F. A. Santori, reviewed through the theoretical contributions and refined concepts of the discourse analysis and literary pragmatics...	35
KLARA KODRA	Evolution of form and message in De Rada's early writings and in "Songs of Milosao".....	61
ARIAN LEKA	The miniature poetry in the Albanian language and "Abbreviations-Shkurtimat", by Xhevahir Spahiu.....	81
<b>MATERIALS AND DOCUMENTS</b>		
HAJRI SHEHU	A large dictionary of the Albanian language is to be carried out.....	113
THOMA LEKA	The Kadhës dialect.....	119
<b>CRITIQUES AND BIBLIOGRAPHY</b>		
ANILA OMARI	Dhori Qirjazi, <i>Bleta shqyptare</i> , Introductory study and facsimile edition by.....	161
<b>SCIENTIFIC LIFE</b>		
	Scientific symposium "Aleksandër Xhuvani in Albanian Lexicography" (T. Toska, E. Karaj).....	167